



Stadi: 01/09/2017

**Aplikim për vizë me qëllim punësimi
(Karta Blu e BE-së dhe profesione të kualifikuara)**

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhënë bashkëngjitur. Duke qenë i/e përgatitur mirë ju mund të ndikoni pozitivisht dhe të shkurtoni procedurën përkatëse.

I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në original!

Në rastin e aplikimit për një vizë punësimi Ambasada, si rregull, duhet të përfshijë në procedurë Agjencinë Federale të Punës (ZAV) dhe në raste të veçanta edhe zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Për këtë arsye procedurat zgjasin zakonisht deri në 8 javë, por në raste të veçanta edhe më shumë se kaq.

Të gjitha dokumentat që tërhiqen pranë Ambasadës (fletët e informacionit, formularët e aplikimit) janë gratis. Të gjitha informacionet rreth procedurës së aplikimit i gjeni në faqen e internetit të Ambasadës www.tirana.diplo.de në rubrikën e rregullave për vizë.

Lutemi të vini re udhëzimet e dhëna për çdo pikë, në mënyrë të veçantë numrin e kopjeve të nevojshme.		
1.	Pashaporta e udhëtimit <i>+ 2 kopje (të gjitha faqet e rëndësishme)</i>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
2.	2x formularë aplikimi për viza kombëtare	Në gjermanisht ose anglisht, të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkruara personalisht. Jo aplikime për vizë Schengen!!
3.	3x fotografi	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj.
4.	Tarifa	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhen kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 75 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
5.	Ofertë e një vendi pune me karakter detyrues ose kontratë pune e nënshkruar <i>+ 2 kopje</i>	Oferta e vendit të punës me karakter detyrues, e cila duhet të përmbajë të dhënat rreth pagës, kohës së punës dhe ditëve të pushimit ose kontrata e punës e nënshkruar prej të dy palëve kontraktuese.
6.	Dëshmi kualifikimi	P.sh. diploma, dëshmi, të përkthyer dhe

	+ 2 kopje	<p>vërtetimi i njohjes së kualifikimit:</p> <p>Nëse diploma juaj e shkollës së lartë është e krahasueshme me një diplomë gjermane dhe nëse shkolla e lartë përkatëse njihet si e tillë në Gjermani, këtë mund ta verifikoni në Bazën e të Dhënave ANABIN: http://anabin.kmk.org/ – duhen paraqitur të dy dokumentat.</p> <p>Nëse diploma juaj e shkollës së lartë nuk është e regjistruar në këtë Bazë të Dhënash, atëherë duhet të bëni vlerësimin e diplomës suaj nga Zyra Qendrore për Arsimin me Jashtë (ZAB): http://www.kmk.org/zab/zeugnisbewertungen-fuer-auslaendische-hochschulqualifikationen.html</p>	
7.	Leja për ushtrimin e profesionit (nëse kërkohet) + 2 kopje	Nëse për ushtrimin e profesionit kërkohet një leje përkatëse (p.sh. mjek), atëherë kjo leje apo garantimi i lëshimit të saj duhet të paraqitet maksimalisht deri në momentin e tërheqjes së vizës.	
8.	Eventualisht dëshmi për një siguracion shëndetësor të mjaftueshëm + 2 kopje	Kjo dëshmi duhet të paraqitet, vetëm nëse prej kontratës së punës nuk rezulton se është punëdhënësi, ai që e merr përsipër siguracionin shëndetësor.	

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.